



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr 3618/3prot

Tiranë, më 13/ 05 / 2014

**Lënda:** Procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese si dhe formati i vërtetimit .

PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË APLIKIMIT PËR NJOHJE NGA KMR SI  
EKSPERT I KUALIFIKUAR PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET  
JOJONIZUESE SI DHE FORMATI I VËRTETIMIT

Mbështetur në Ligjin 10469 datë 13/Tetor /2011, dhe rregulloren “ Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese” nr 743 ,datë 16/10/2012 dhe nenit 4.2.3 “...të jenë të pajisur me vlerësimin për shpërndarjen e rrezatimit nga ekspertë të mbrojtjes nga rrezatimi të njohur nga KMR për cdo burim ose grup burimesh në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese. Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi përcakton kriteret e mëposhtme për ekspertët e kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese dhe procedurat për njohjen nga ana e KMR-së

Aplikimi për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese bëhet për të gjitha veprimtaritë që i parashikon ligji 10469 datë 13/Tetor 2011, sipas rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”. Aplikimi për njohje bëhet pranë ZMR tek personi i ngarkuar për këtë qëllim (jo në mënyrë elektronike ose me postë ). Personi përgjegjës pret aplikuesin dhe i sqaron kriteret për vlerësim. Pas plotësimit të dokumentacionit, ai dorëzohet në ZMR duke shënuar datën e dorëzimit, nr e fletëve, sipas formatit të përcaktuar dhe mbahet në dy kopje. Një kopje i jepet aplikuesit si vërtetim i dorëzimit të dokumentacionit. Personi përgjegjës i ZMR-së bën një vlerësim të përgjithshëm të aplikimit duke parë plotësimin e të gjithë rubrikave dhe pas plotësimit të dosjes, ajo siglohet në faqen e parë dhe i paraqitet Kryetarit të ZMR për vlerësimin e aplikimit për njohje eksperti nga ana e KMR-së. Në varësi të dokumentave të dorëzuara kryetari e delegon për vlerësim tek grupi i vlerësimit, i cili bën një vlerësim me shkrim në lidhje me dokumentat e paraqitura jo më vonë se tre muaj nga momenti i aplikimit. Vlerësimi realizohet kundrejt kriterëve të miratuara nga ana e KMR-së. Grupi i vlerësimit përbëhet nga përfaqësues të njohur në këtë fushë përfaqësues nga universiteti i Tiranës sic e përcakton KMR. Me përgatitjen e vlerësimit, ai dërgohet me shkrim tek sekretari i KMR-së së bashku me dosjen përkatëse. Sekretari i KMR-së përgatit propozimin për njohje nga ana e KMR-së në mbledhjen e radhës për vlerësimin përfundimtar. KMR mban inventarin e dosjeve dhe vlerësimeve.

Me propozim te grupit të punës të ngritur për këtë qëllim, KMR vendosi se do të njohë si ekspertë të kualifikuar të mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese ato persona të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme.

Ky dokument nuk është për përdorim zyrtar

Kritere Vlerësimi :

- 1-Disponojnë diplomë në degën e fizikës pesëvjeçare, ose diplomë në degën elektronikë , elektrike ose telekomunikacion
- 2-Eksperiencë pune prej 10 vitesh në këtë fushë
- 3-Kualifikime të ndryshme në fushën e rrezatimeve jojonizuese, të cilat të përfshijnë:

Bazat e fizikës rrezatimeve jojonizuese  
Efektin biologjik të rrezatimeve jojonizuese  
Matje të rrezatimit të fushës elektromagnetike  
Vlerësim i ekspozimeve ndaj rrezatimit elektromagnetik  
Të njohë legjislacionin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese.

-KMR njeh si ekspertë persona fizikë, jo institute private.

-Komisioni i vlerësimit përbëhet nga zotërinjtë:

- 1-Halil Sykja
- 2-Shkëlqim Mema
- 3-Dritan Spahiu

Në rast të ankesave, aplikuesi i drejtohet Kryetarit të KMR-së me një letër ankese me sqarimet përkatëse. Nqs dhe në këtë rast i refuzohet kërkesa, personi mund ti drejtohet gjykatës.

---

SEKRETARI

Rustem PACI

---

KRYETARI

Ilir BEQAJ

Formati i VERTETIMIT

VËRTETIM

Vërtetojmë se Z./Znj.....  
ka dorëzuar në ZMR dosjen për aplikim për

.....  
Me nr rendor .....datë.....  
Numri i faqeve në total .....

| Personi përgjegjës për pranimin e dokumentacionit në ZMR | Personi juridik ose fizik që dorëzoi dokumentat                       |
|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| Emër _____<br>Mbiemër _____<br><br>Firmë                 | Emër _____<br>Mbiemër _____<br><br>Nr karte identiteti _____<br>Firmë |

Ky vërtetim nuk e përjashton ekspertin nga asnjë lloj detyrimi tjetër ligjor